



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT  
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT « ENFORCEMENT GROUP» SHPK

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall. e Shoqërisë "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane / Cel. 0692087566  
e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com

Nr. 871/4 Prot.  
Nr. 1880 Regj.

Tirane me, 01.03.2021

**URDHËR  
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE  
MBI KUOTAT E DEBITORIT**

**Drejtuar :** Qendres Kombetare te Biznesit/Tiranë  
**Per dijeni:** Debitorit Shoqëria "Kotica" shpk, me Nipt J97507310P  
**Adresa:** Super Stradë, Laç.

**Për dijeni:** Kreditorit Shoqëria "Eurotech Cement" sh.p.k, Nipt J72318015F  
**Adresa:** Lagja 14, Shkozë, Durrës.

Unë Altin Latifi me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes me Nr.1880 Regj, bazuar në Urdhrit e ekzekutimit Vendimi Nr. 1019-181 datë 09.10.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.



**KONSTATOVA**

Se pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, është depozituar për Ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria "Eurotech Cement" sh.p.k, së bashku me Titullin Ekzekutiv Deklarata Noteriale nr. 1569 Rep., Nr. 871 Kol., datë 17.08.2020 lëshuar nga Shoqëria "Kotica" shpk, për të cilën ka dalë Urdhri i ekzekutimit Vendimi Nr. 1019-181 datë 09.10.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë e objekt:

**Kreditor:** Shoqëria "Eurotech Cement" sh.p.k, Nipt J72318015F  
**Debitor:** Shoqëria "Kotica" shpk, me Nipt J97507310P  
**Objekti:** Pagim shume

**Me anë të këtij Urdhri ekzekutimi është vendosur :**

-Lëshimi i Urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Deklarata Noteriale nr. 1569 Rep., Nr. 871 Kol., datë 17.08.2020 lëshuar nga Shoqëria "Kotica" shpk.

-Detyrimi monetar i papaguar në vlerën prej 12,123,940 (dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e dyzet) lekë, deri në datën e përmbushjes së plotë të detyrimit, debitori duhet të paguajë dhe kamatëvonesën, në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".

Në kushtet kur debitori nuk e shleu vullnetarisht detyrimin atëherë nga ana jonë në bazë të nenit 519 K.P.Civile kemi vijuar me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm duke vendosur sekuestro mbi pasuritë e palës debitore.

Për rrjedhojë me qëllim vijimin e procedurave përmbarimore dhe ekzekutimin e Urdhrit të ekzekutimit të sipërcituar duhet vijuar me vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe kuotat e debitorit.

**Për sa më sipër:** Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

Vlera e detyrimit të derdhet në llogarinë bankare të vecantë të përmbaruesit pranë BKT sha me emertimin Zyra e Përmbarimit Privat Enforcement Group shpk – Altin Latifi Llogari Përmbaruesi e Vecante me numër llogarie 425786282CLPRBLALLAC dhe IBAN: AL2120511258786282CLPRBLALLA.

## URDHËROJ:

- 1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kuotat e Shoqëria "Kotica" shpk, me Nipt J97507310P me seli në Super Stradë, Laç.
- 2.Kuotat e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdher te dyte nga ana e zyres sone permbarimore.
- 3.Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4.Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdheri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne nenit 606 te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
- 5.Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.
- 6.Pas dergeses se ketij urdheri per vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit te sipercituar ne shoqerite e sipercituara, kerkojme te na dergohet prane zyres sone statusi i aksioneve pas kryerjes se bllokimit, brenda afatit ligjor.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALTIN LATIFI

A handwritten signature in black ink is written over a blue circular stamp. The stamp contains the text "PËRMBARUESI GJYQËSOR" and "ENFORCEMENT GROUP" around a central emblem.

Vlera e detyrimit të derdhet në llogarinë bankare të vecantë të përmbaruesit pranë BKT sha me emertimin Zyra e Permbarimit Privat Enforcement Group shpk – Altin Latifi Llogari Përmbaruesi e Vecante me numër llogarie 425786282CLPRBLALLAC dhe IBAN: AL2120511258786282CLPRBLALLA.